



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS - TUZILAKU I SHTETI I KOSOVËS SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT ARKIVA - ARHIVA		
Pranuar 28 -07- 2020 Priljeno		
Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Nenshkrimi pranuesit Potpis primaoca
713		

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVES
VRHOVNI SUD KOSOVA– SUPREME COURT OF KOSOVO

AA.nr.8/2020

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Gyltene Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike disiplinore ndaj Valbona Disha Haxhosaj, prokurore në Prokurorinë Themelore në Pejë, kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej KPK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së prokurores Valbona Disha Haxhosaj, paraqitur kundër Vendimit KPK/Nr. 308/2020, datë 17 Qershor 2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28 korrik 2020 morri këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë, ankesa e prokurores Valbona Disha Haxhosaj, prokurore në Prokurorinë Themelore në Pejë, e paraqitur kundër Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr. 308/2020, datë 17 Qershor 2020.



Arsyetim

Me vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr. 308/2020, datë 17 qershor 2020, në pikën I, aprovohet si i bazuar Raporti i Penalit hetimor, AD nr.06/2019-ADnr. 10/2020 i datës 5 qershor 2020, në rastin disiplinor kundër prokurores Valbona Disha Haxhosaj, prokurore në Prokurorinë Themelore në Pejë. Në pikën II të vendimit vërtetohet se prokurorja është përgjegjëse për shkelje disiplinore të përcaktuara me nenin 6, paragrafi 1, pika 1.3 lidhur me par.2 pika 2.1 Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në pikën III të dispozitivit, prokurores Valbona Disha Haxhosaj, i shqiptohet masa disiplinore *"Zvogëlim i përkohshëm i pagës në tridhjetë për qind 30% për një periudhë kohore katër (6) muaj"* në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër këtij Vendimi, prokurorja Valbona Disha Haxhosaj, në afat ka paraqitur ankesë, për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale të përcaktuara me ligj dhe gabimeve faktike që kanë ndikuar në procedurë dhe vendimmarrje lidhur me masën disiplinore, me propozim që Gjykata Supreme ta aprovoi ankesën dhe të anuloi vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në përgjigje ndaj ankesë së prokurores pretendon se ankesa është e pa bazuar dhe se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë edhe për faktin se Prokuroja e ka pranuar pa vërejtje gjendjen faktike në të dy rastet. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se sanksioni disiplinor ndaj prokurores është adekuat, në përputhje me të gjeturat e panelit hetimor dhe do të ketë efekt pozitiv në punën e prokurores në të ardhmen.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të vendimeve të atakuar në kuptim të nenit 15 të Ligjit për përgjegjësin disiplinore të gjyqtarëve dhe Prokuroreve (Ligji numër 06/L-057) dhe rregullores (05/2019) për Procedurën disiplinore të Gjyqtarëve të datës 27.05.2019 ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Në shkresat e lëndës del se me datën 4 dhjetor 2019, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka pranuar propozimin për fillimin e procedurës hetimore ndaj Valbona Disha Haxhosaj, prokurore



në Prokurorinë themelore në Pejë me propozim që të njëjtës ti shqiptohet masa vërejtje jopublike. Me 19 mars 2020 po ashtu ka pranuar propozimin për fillimin e procedurës hetimore ndaj prokurores me propozim që ti shqiptohet masa vërejtje publike.

Këshilli Prokurorial i Kosovës konform dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-056 për KPK-në dhe nenin 12 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, formoi panelin hetimor i cili i bashkoi procedurat disiplinore në të dy rastet dhe zbatoi procedurën e paraparë me ligj.

Me 11 qershor 2020, Paneli Hetimor i ka dorëzuar raportin Këshillit Prokurorial të Kosovës me përfundim se Prokuroja Valbona Disha Haxhosaj, ka shkelur dispozitat e nenit 6 paragrafi 2.1 Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe dispozitat e Kodit të etikës sepse në rastin e parë, AD.nr. 06/2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi ashtu që në lëndën penale, [REDAKTUAR], ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga "Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike", nga neni 229 i Kodit Penal të Kosovës në veprë penale "posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose anologe" nga neni 269 i KPK-së. Sipas pretendimit të prokurores ky rikualifikim është bërë me pretendimin e aplikimit të ligjit më të favorshëm për të akuzuarin edhe pse kjo në kohën e kryerjes me 27 prill 2010 nuk ka qenë fare e inkriminuar si veprë penale. Në rastin e dytë AD.nr.10/2020, përkatësisht tek aktakuza [REDAKTUAR] nuk ndërmarr veprim prokurorial që kërkohet me ligj, respektivisht pasi rasti është kthyer në rigjykim, në fillim të seancës pa administruar provat, ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga "Trafikim me njerëz nga neni 139 paragrafi 1, lidhur me nenin 23 të KPK-së, në veprën penale "mundësim i prostitucionit" nga neni 201 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Në kësi rrethanash KPK-ja pasi shqyrtoi provat dhe dëgjoi palët, në seancën e datës 17 qershor 2020 vendosi si në dispozitivin e vendimit të atakuar.

Gjykata Supreme gjene se janë zbatuar drejtë dispozitat e nenit 15 të Ligjit që rregullojnë çështjen e ankimit ndaj vendimeve të KGJK-së, pranë Gjykatës Supreme të Kosovës dhe pika 4 e këtij neni parasheh se ankesa ndaj vendimeve të Këshillit mundë të ushtrohet në rast të zbatimit të gabuar të Ligjit (4.1) dhe në rast të shkeljes procedurale të përcaktuar me ligj (4.2). Por bazuar në shkresat e lëndës dhe arsyetimin e Vendimit të KPK-së, ankesa e prokurores është ushtruar



ndaj vendimit të KPK-së nuk mbështetet në fakte. Këshilli Prokurorial i Kosovës ka vepruar në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit në fuqi për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka dëshmuar se është bërë shkelje disiplinore nga prokurorja, i ka shqiptuar masën disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe ka marrë parasysh edhe seriozitetin, pasojat, rrethanat në të cilat është kryer shkelja. Prandaj pretendimet e ankesës për aplikim të gabuar të së drejtës materiale janë të pa bazuara dhe si të tilla u refuzuan. janë të paqëndrueshme.

Në seancën e KPK-së të mbajtur me 17 qershor 2022, subjekti hetimor, Prokurorja Valbona Disha Haxhosaj nuk e kundërshtoi gjendjen dhe gjetjet faktike te panelit hetimor i cili kishte konstatuar se ka lëshime të cilat bien ndesh me Kodin e etikës dhe sjelljes profesionale të Prokurorëve .

Këshilli Prokurorial i Kosovës duke u nisur nga gjendja e këtillë faktike ka vërtetuar në veprimet e prokurores janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore që bien ndesh me dispozitat e Kodit të Etikës të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe i shqiptoj sanksionin disiplinor zvogëlim i përkohshëm i pagës në 30% (tredhjet për qind) për një periudhë 6 (gjashtë) mujore, në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.3, të ligjit të lartcekur.

Gjykata Supreme e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Prokurorial të Kosovës, është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar është i ligjshëm dhe është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës material kur është vërtetuar përgjegjësia disiplinore e prokurores për shkeljen e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror dhe nenit 6, paragrafi 1 pika 1,3 lidhur me paragrafi 2, pika 2.1 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe vendimi përkitazi me masës e shqiptuar disiplinore të marrë për këto shkelje.

Veprimet e Prokurores në të dy rastet janë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Kodit të Etikës së Sjelljes Profesionale për prokuroret, respektivisht nenin 3.3 që parasheh se Prokurori duhet të shmang çdo sjellje apo situatë, që vë në pikëpyetje integritetin dhe paanshmërinë e tij/saj dhe ti përmbahet ligjit. Në rastin konkret kur ka kërkuar rikualifikimin e veprës penale, është dashtë të vazhdoi procedurën në shqyrtim gjyqësor dhe vetëm pas përfundimit të shqyrtimit, mbi bazën e provave të administruara të shikoi mundësinë e rikualifikimit apo heqjes dorë nga ndjekja.



Pretendimet në ankesë se veprimet e prokurores në të dy rastet janë çështje profesionale dhe lidhen me ushtrimin e funksionit dhe nuk janë të kualifikuara si përgjegjësi disiplinore nuk mund të pranohen për arsye të dhëna në vendimin e KPK-së dhe të përcaktimeve ligjore sepse vetë faza e procedurës dhe mënyra e kërimit të rikualifikimit e bëjnë përgjegjëse prokuroren. .

Gjykata Supreme konsideron masat disiplinore e shqiptuar është e ligjshme dhe në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.3, Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh: seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga prokurorja , pasojat e shkeljes disiplinore; rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; përsëritjen e shkeljeve etj. . Rrjedhimisht, sanksioni disiplinor i shqiptuar është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e Panelit hetimor, i cili sanksion do të ketë efekt pozitiv për ashtu që i njëjti në të ardhmen të veproj konform Rregullave të Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale për prokuror. Prandaj, parashtrimet në ankesë lidhur me masën disiplinore të shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara.

Nga sa u tha në ankesë e në pajtim me nenin 15.6 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË



AA nr. 8/2020 më 28 korrik 2020



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTEKON
TACNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Kryetari i Kolegjit

Beshir Islami

Punëtori i autorizuar
Dy-lashcepi radnik